

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE  
TIRANE



NOTERE  
Gelanda Shkurtaj  
NIPT: L31929011T

Adresa: Rr. "Kavajës, P.136, Sh.4.Apt.27; Tel: (355) 4 222 1696 Mob.: 0673372795

No. 189 Rep.  
No. 172/1 Kol.

### KONTRATE SHITJE

Në Tiranë, sot më 27. 4. 2015 (dymijë e pesëmbëdhjetë), para meje noteres publike Gelanda SHKURTAJ, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli në rrugën e "Kavajës", p.136, sh.4, apt.27, Njësia Bashkiake Nr. 7, u paraqit personalisht:

**SHITESI: Z. AGRON XHANI**, i biri i Kujtimit, shtetas shqiptar, lindur më 15/03/1970, në Kajcë (Përmet) dhe banues në Tiranë, Njësia Bashkiake n.6, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nëpërmjet kartës së identitetit me Nr.026558861 dhe me numër personal H00315236I (**këtu e më poshtë, per efektet e kësaj kontrate referuar si Shitësi**);

**BLERESI: Z. ZAMBAK XHANI**, i biri i Haxhiut, shtetas shqiptar, lindur më 27/05/1970 në Përmet dhe banues në Tiranë - Njësia Bashkiake Nr. 6 rruga "Llazi Miho", madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova me Letërnjoftimin ID me Nr. Personal H00527128L (**këtu e më poshtë, për efektet të kësaj kontrate referuar si Blerësi**);

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, nenit 705 e në vijim të tij, si edhe Ligjit nr.9901, datë 14/4/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, bien dakort të hartojnë këtë Kontratë Shitjeje të kuotave, sipas kushteve dhe kriterëve të mëposhtme:

#### NENI 1

##### Objekti

Shoqëria "MOBITEL COMMUNICATION" – SH.P.K., nga të dhënat që rezultojnë nga "Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar", nxjerrë nga zyra QKR-se më datë 10.04.2015, është themeluar më 08/03/2003 dhe



regjistruar si person juridik në QKR më datë 08/04/2003 me Nr. NIPT K31608121J me kapital 58.450.000,00 (pesëdhjetë e tetë milionë e katërqind e pesëdhjetë mijë LEKE), numri i pjesëve 29.225,00 (njëzet e nëntë mijë e dyqind e njëzet e pesë), vlera nominale e secilës kuotë 2.000,00 (dy mijë leke).

Gjithashtu, nga "Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar", rezultojnë se:

**Shitësi:** **AGRON KUJTIM XHANI** është pronar i 100 (njëqind) kuotave, me vlerë nominale 2.000,00 (dymijë) LEKE secila kuotë dhe që përbëjnë 100 % (njëqindpërqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë, dhe

Shitësi, **AGRON KUJTIM XHANI**, më deklaron dhe më garanton se me dëshirën dhe vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, të gjitha kuotat respektive të kapitalit themeltar të Shoqërisë "MOBITEL COMMUNICATION" SH.P.K., me seli në Tiranë në rrugën e "Kavajës", qendra "Gurten" n.208, ia shet të lira nga cdo barrë apo e drejtë tjetër reale, Z. **ZAMBAK HAXHI XHANI**, ashtu siç shprehet edhe në Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë "MOBITEL COMMUNICATION" SH.P.K., datë 10/04/2015.

Blerësi, **ZAMBAK HAXHI XHANI**, më deklaron dhe më garanton se **deshiron t'i blejë** kuotat e sipërpërkruara që zotëron shitësi në shoqërinë "MOBITEL COMMUNICATION" SH.P.K.

**ENI 2**

**Çmimi i shitjes dhe menyra e pageses**

Çmimi i shitjes së kuotave të kapitalit themeltar që Shitësi zotëron në Shoqërinë "MOBITEL COMMUNICATION" SH.P.K., dhe që përbëjnë objektin e kësaj kontrate, është në vlerën:

- **5.000.000,00 (pesë milionë) LEKE** është vlera e 29.225,00 (njëzet e nëntë mijë, dyqind e njëzet e pesë, zero zero) kuotave që zotëron **AGRON XHANI** dhe që përbëjnë 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- **Vlera totale e kuotave të kapitalit themeltar që Shitësi zotëron në Shoqërinë "MOBITEL COMMUNICATION" SH.P.K. është 58.450.000,00 (pesëdhjetë e tetë milionë e katërqind e pesëdhjetë mijë) LEKE.**

Vlera e çmimit të shitjes i është paguar Shitësit njëherësh jashtë kësaj zyre Noteriale, nëpërmjet transaksionit bankar, gjë të cilën e vërtetojnë vetë palët dhe mandati i kalimit do t'i bashkëngjitet këtij akti.



### NENI 3

#### Kalimi i pronësisë

Palet bien dakort që kjo Kontrate Shitje do të prodhoj efektet juridike të parashikuara nga Nenet 705 e në vijim të K.C., si dhe në Ligjin nr. 9901, datë 14/4/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar. Në këto kushte, me firmosjen e kësaj kontrate nga palët kontraktuese, nënshkrimin e saj nga unë noterja, si dhe me depozitim të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, Blerësit **ZAMBAK HAXHI XHANI** i kalon e drejta e pronësisë mbi kuotat e përshkruara në nenin 1 të kësaj kontrate, të lira nga çdo barrë apo e drejtë tjetër reale, ndërsa Shitësi, **AGRON KUJTIM XHANI** zhvishet nga pronësia për kuotat respektive të kapitalit themeltar të Shoqërisë "MOBITEL COMMUNICATION" SH.P.K dhe largohet nga Shoqëria, duke mos patur në të ardhmen asnjë të drejtë dhe detyrim ndaj saj.

Blerësi, **Z.ZAMBAK HAXHI XHANI** me blerjen e kuotave – objekt i kësaj kontrate, nga Shitësi, Blerësi bëhet pronar i 29.225,00 (njëzet e nëntë mijë, dyqind e njëzet e pesë, zero zero) kuotave, me vlerë nominale 2.000,00 (dymijë) LEKE secila kuotë dhe që përbëjnë 100 % (njëqind për qind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

### NENI 4

#### Garancitë e palëve

- Pala shitëse deklaron dhe garanton se është pronar i vërtetë dhe i vetëm i kuotave respektive të kapitalit themeltar që Shitësi zotëron në Shoqërinë "MOBITEL COMMUNICATION" SH.P.K.

- Shitësi deklaron gjithashtu se, kuotat respektive të kapitalit themeltar të Shoqërisë janë nënshkruar dhe shlyer prej tyre; në tërësinë e tyre dhe se këto kuota nuk janë të rënduara me të drejta reale në favor të personave të tretë dhe të cilat mund të jenë shkak për mbështetjen e pretendimeve të të tretëve, të cilat mund të sjellin për pasojë cënimin e të drejtës së pronësisë së Blerësit, si dhe nuk janë të rënduara me barrë siguroese, fakt ky i vërtetuar nga rezultati i RBS i kërkuar nga unë noterja në bazë të Udhëzimit nr. 2007/1, datë 2/3/2010 « Për rastet kur noterët kërkojnë informacion të shkruar mbi të dhënat e regjistrimit të barrëve siguroese dhe procedurat që ndiqen në këto raste».

- Blerësi ka pranuar blerjen e kuotave të zotëruara nga Pala Shitëse, sipas vlerës së përcaktuar në nenin 2 më sipër të kësaj kontrate dhe deklaron dhe garanton se e ka likuiduar totalisht jashtë kësaj zyre noteriale vlerën e çmimit të shitjes, gjë të cilën e vërteton dhe pala shitëse.

Blerësi, deklaron dhe garanton se me blerjen e kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë, të përshkruara në nenin 1 të kësaj kontrate, merr përsipër të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin mbi bazën e pronësisë së këtyre kuotave.

#### NENI 5

##### **Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni, zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Kjo kontratë, është hartuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe konkretisht të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 705 e në vijim të tij, si edhe Ligjit nr. 9901, datë 14/4/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

Për sa i përket çështjeve që kjo kontratë nuk i rregullon shprehimisht, ato do të rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil.

Çdo mosmarrëveshje që mund të lind nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate midis dy palëve, do të zgjidhen me bisedime dhe mirëkuptim të ndërsjelltë midis dy palëve në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Kur midis palëve nuk arrihet zgjidhja e çështjeve me mirëkuptim, secila prej palëve mund ti drejtohet për zgjidhje Gjykatës kompetente.

#### NENI 6

##### **Shpenzimet e Kontratës**

Shpenzimet për përpilimin e Kontratës së Shitjes, shpenzimet noteriale dhe shpenzimet e tjera të lidhura me të, janë në ngarkim të Blerësit.

#### NENI 7

##### **Hartimi i Kontratës**

Kontrata përbëhet nga 4 (katër) fletë dhe hartohet në 5 (pesë) ekzemplarë të njëjtë dhe të barazvlefshëm. Secila prej tyre ka përmbajtje të njëjtë ligjore dhe secila palë do të mbajë nga një ekzemplar. Një ekzemplar e mban noteri duke e arshivuar në zyrën e tij noteriale, ndërsa një ekzemplar tjetër depozitohet pranë QKR-së.

Kjo kontratë pasi iu lexua me zë të lartë palëve dhe u gjet sipas vullnetit të lirë dhe të plotë të tyre, u nënshkrua prej tyre para meje Noteres dhe unë e vërtetoj atë sipas ligji.

#### **PALET KONTRAKTUESE**

**SHITESI**

**BLERESI**

*Agon Xhani*  
*[Signature]*



*Zambek Xhani*  
*[Signature]*

Procredit bank Nr. I ransak./I ransac. No.: 1/918/339  
Branch: Rr Kavajes  
09.04.2015 15:46:22 Ilda Bylykbashi

**Urdhër Transfertë e Brendshme/Money Transfer Order**

Emri i Klientit Urdhërues/Name of Ordering Client:  
**XHANI ZAMBAK HAXHI**  
Nr. Iban/Iban No: **AL8420911067000006058529000**

Pershkrimi i llogarisë/Desc of Account :  
**Llogari rrjedhese/Current account**  
Adresa/Address: **RR.FORTUZITirane**

Emri i Klientit Përfutës/Name of Beneficiary Client:  
**XHANI AGRON KUJTIM**  
Nr. Iban/Iban No: **AL48209110670000068947410001**

Pershkrimi i llogarisë/Desc of Account :  
**Llogari rrjedhese/Current account**  
Adresa/Address:

Shuma e pagesës/Amount of Payment:  
2500000.00 ALL **Dy milion? pesëqind mijë**

Komisioni/Service Charge:  
Kursi i Këmbimit/Exchange Rate: **1.0000**

Shuma Totale/Total Amount  
**2500000.00 ALL**

Detajet e Pagesës/Payment Details: **Pagese e pjeses se mbetur te kuotave te kompanise Mobitel Communication shpk nga Zambak Xhani per Agron Xhani**

Kodi i Qëllimit / Purpose Code: **Transferte e brendshme ( shlyerje detyrimi )**

Emri Mbiemri, Nënshkrimi i klientit  
Name Surname, Customer Signature

Nënshkrimi i punonjësit të bankës  
Signature, Stamp Bank Employee

*Zambak Xhani*

*[Signature]*

Procredit bank Nr. I ransak./I ransac. No.: 1/9103904  
Branch: Rr Kavajes  
08.04.2015 15:27:28 Ilda Bylykbashi

**Urdhër Transfertë e Brendshme/Money Transfer Order**

Emri i Klientit Urdhërues/Name of Ordering Client:  
**XHANI ZAMBAK HAXHI**  
Nr. Iban/Iban No: **AL8420911067000006058529000**

Pershkrimi i llogarisë/Desc of Account :  
**Llogari rrjedhese/Current account**  
Adresa/Address: **RR.FORTUZITirane**

Emri i Klientit Përfutës/Name of Beneficiary Client:  
**XHANI AGRON KUJTIM**  
Nr. Iban/Iban No: **AL48209110670000068947410001**

Pershkrimi i llogarisë/Desc of Account :  
**Llogari rrjedhese/Current account**  
Adresa/Address:

Shuma e pagesës/Amount of Payment:  
2500000.00 ALL **Dy milion? pesëqind mijë**

Komisioni/Service Charge:  
Kursi i Këmbimit/Exchange Rate: **1.0000**

Shuma Totale/Total Amount  
**2500000.00 ALL**

Detajet e Pagesës/Payment Details: **Pagese per blerjen e gjysmes se Kuotave te kompanise Mobitel Communication shpk nga Zambak Xhani per Agron Xhani**

Kodi i Qëllimit / Purpose Code: **Transferte e brendshme ( shlyerje detyrimi )**

Emri Mbiemri, Nënshkrimi i klientit  
Name Surname, Customer Signature

Nënshkrimi i punonjësit të bankës  
Signature, Stamp Bank Employee

*[Signature]*